

V E N D I M
Nr. 228, datë 24.5.2002

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 335, DATË 23.6.2000 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR RREGULLAT E PROKURIMIT PUBLIK"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 "Për prokurimin publik", me ndryshimet përkatëse, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.335, datë 23.6.2000 të Këshillit të Ministrave "Për rregullat e prokurimit publik" të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Shkronja "a" e pikës 1 ndryshon si më poshtë vijon:

"a) Enti prokurues të përdorë procedurën e prokurimit "Tender i hapur", në përputhje me nenin 23 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 "Për prokurimin publik", kur vlera e përlogaritur e kontratës është mbi 5 (pesë) milionë lekë për prokurimin e ndërtimeve, mbi 3 (tre) milionë lekë për prokurimin e mallrave dhe mbi 1 (një) milionë lekë për prokurimin e shërbimeve, me përjashtim të projekteve, ku si referim të merret vlera e parashikuar për sipërmarrjen e ndërtimit të objektit dhe jo ajo e shërbimit.

Enti prokurues të përdorë procedurën "Tender i hapur ndërkombëtar", kur vlera e përlogaritur e kontratës është mbi 300 (treqind) milionë lekë."

2. Në pikën 2 fjala "projekteve" zëvendësohet me "projekteve".

3. Në pikën 4 të bëhen këto ndryshime:

Shkronja "a" ndryshon si më poshtë vijon:

"a) Pika 1/b/c/ç, për vlerë jo më të madhe se 30 për qind e kontratës fillestare, kur nevoja për këtë shtesë del gjatë kohës së realizimit të kontratës, deri në 3 muaj pas përfundimit të saj."

- Fjalja e parë e shkronjës "b" ndryshon si më poshtë vijon:

"b) Për prokurimet me vlerë të vogël, kur vlera e përlogaritur e prokurimit për çdo artikull ose zë nuk është më e madhe se 300 (treqind) mijë lekë brenda një vitit kalendarik. Me artikull, në kuptim të këtij vendimi, do të kuptohet një grup mallrash, që kanë të njëjtin emër dhe funksion kryesor."

- Pas shkronjës "c" shtohet shkronja "ç", me këtë përmbajtje:

"ç. Entet prokuruese, për plotësimin e nevojave të fillimit të çdo viti, lejohen të lidhin kontrata shtesë me kontraktuesit e tyre të fundit për mallrat apo shërbimet. Kjo kontratë shtesë do të jetë e vlefshme vetëm për periudhën deri në datën e nënshkrimit të kontratave, për fondet e vëna në dispozicion."

4. Në pikën 7 bëhen këto ndryshime:

Shkronja "a" dhe "b" ndryshojnë si më poshtë vijon:

"a) te titullari i entit prokurues për të gjitha prokurimet me vlerë jo më të madhe se 5 (pesë) milionë lekë.

b) te titullari i organit, qendror ose vendor, për prokurimet me vlerë mbi 5 (pesë) milionë lekë, por jo më të madhe se 100 (njëqind) milionë lekë."

5. Fjalja e parë e pikës 10 ndryshon si më poshtë vijon:

"10. Të gjitha entet prokuruese të dërgojnë për botim në Agjencinë e Prokurimit Publik ftesën për ofertë për "Tender i hapur", "Tender i kufizuar" dhe "Kërkesë për kuotim", jo më vonë se 10 ditë përpara shpalljes së saj, me përjashtim të rasteve të përdorimit të procedurës së prokurimit, sipas pikës 3 të nenit 17 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 "Për prokurimin publik..."

6. Pika 11 ndryshon si më poshtë vijon:

"11. Entet prokuruese, brenda datës 30 janar, të paraqesin në Agjencinë e Prokurimit Publik statistika të sakta për planifikimin vjetor të prokurimeve. Gjithashtu, të paraqesin pranë Agjencisë së Prokurimit Publik edhe ndryshimet e planit të prokurimeve publike gjatë vitit kalendarik. Entet prokuruese, në fund të çdo 4-mujori, brenda datës 20 të muajit pasardhës të paraqesin në Agjencinë e Prokurimit Publik një tregues për realizimin apo jo të prokurimeve të planifikuara, të shoqëruar me relacionin shpjegues. Për realizimin e kësaj detyre, titullari i entit prokurues ngarkon njësinë e

prokurimit (nëse ka) apo strukturën përgjegjëse, që planifikon fondet e prokurimeve të entit. Agjencia e Prokurimit Publik, nga ana e vet, brenda datës 30 të po atij muaji duhet të paraqesë në Këshillin e Ministrave një pasqyrë përmbledhëse të prokurimeve në shkallë vendi."

7. Pika 12 ndryshon si më poshtë vijon:

"12. Për një veprim apo mosveprim të kryer nga një ent prokurues, të cilin një kandidat e vlerëson si shkelje të ligjit ose të rregullave të prokurimit, ai është i lirë të bëjë shqyrtim administrativ brenda këtyre afateve:

a) në entin prokurues brenda 5 (pesë) ditëve pas shpalljes së klasifikimit përfundimtar të ofertave;

b) në organin, qendror apo vendor, i cili vë në dispozicion fondin, brenda 5 (pesë) ditëve pas mbarimit të afatit të ankesës pranë entit prokurues; Organi, qendror apo vendor, është i detyruar të kthejë përgjigje brenda 10 ditëve nga marrja e ankesës.

c) në Agjencinë e Prokurimit Publik brenda 5 (pesë) ditëve pas marrjes së përgjigjes nga organi, qendror apo vendor, që vë në dispozicion fondin."

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko